



Reflektime pas zgjedhjeve parlamentare në BE
Italia merr Presidencën e Këshillit të Bashkimit Europian: Ja Programi dhe Prioritetet
100 vjet më vonë: Kujtojmë Luftën e Parë Botërore

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr. 21 Korrik - Gusht 2014

Speciale

Tiranë, konferencë e nivelit të lartë mbi Presidencën Greke dhe Zgjerimin në Ballkanin Perëndimor



Më 18 qershor 2014, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me Ambasadën e Greqisë në Shqipëri organizuan Konferencën Ndërkombëtare: "Presidenca Greke dhe Zgjerimi në Ballkanin Perëndimor: Situatat aktuale". Konferenca Ndërkombëtare një-ditore në Tiranë synoi të diskutonte situatën aktuale

të zgjerimit të Bashkimit Europian, duke analizuar rolin e Greqisë dhe presidencës së ardhshme italiane, si dhe mësimet e nxjerra nga zgjerimet e

...vijon në faqen 2 >>

Rrugëtimi drejt BE-së, çfarë jep dhe çfarë merr Shqipëria

Ese fituese



Marrja e statusit të vendit kandidat nga Shqipëria, (pas një vendimi historik, nga ana e Këshillit të Ministrave të shteteve anëtare të BE-së në 24 qershor 2014), përbën një arritje jashtëzakonisht të rëndësishme për Shqipërinë, shoqërinë tonë, por edhe për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ky vendim

përbën një sinjal të qartë të lëvizjes në drejtimin e duhur në përpjekjet shumëvjeçare të shndërrimit të vendit tonë në një shoqëri europiane, në harmoni dhe në përputhje me standardet europiane.

...vijon në faqen 7 >>

A ekziston e drejta për shkëputjen e Skocisë dhe Katalonjas prej vendeve përkatëse?



Bashkimi Europian ka nxitur një bashkëpunim të ngushtë politik dhe ekonomik të 28 shteteve anëtare, por në të njëjtën kohë ka mundësuar dhe parashikimin e shpërbërjes së disa prej këtyre vendeve. Pavarësia për një vend të vogël jashtë një grupi politik dhe ekonomik siç është BE-ja do të ishte e rrezikshme në ditët e sotme.

Një shembull specifik i një vendi aspirues për pavarësi është Skocia, ku një referendum popullor do të mbahet më 18 shtator. Kryeministri britanik David Cameron është shprehur kundër largimit të Skocisë nga Mbretëria e Bashkuar, por nuk e ka kundërshtuar mbajtjen

...vijon në faqen 6 >>

Tiranë, konferencë e nivelit të lartë mbi Presidencën Greke dhe Zgjerimin në Ballkanin Perëndimor

...vijon nga faqja 1 >>

mëparshme. Çështje të tjera të analizuara përfshinin rolin e Kuvendit të Shqipërisë në hapat e mëtejshëm të pranimit në BE, si dhe perspektivën e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) në IPA II të ardhshme.

Aktiviteti priti personalitete në fushën e integritimit dhe demokratizimit të vendit si z. Ditmir Bushati, Ministër i Punëve të Jashtme, znj. Klajda Gjoshë, Ministre e Integritimit Europian, znj. Majlinda Bregu, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian, z. Leonidas Rokanas, Ambasador i Greqisë në Shqipëri, z. Clive Rumbold, Chargé d'affaires a.i., Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, z. Vassilis Maragos, Shef i Sektorit për Shqipërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit të Komisionit Europian, z. Massimo Gaiani, Ambasador i Republikës së Italisë në Shqipëri, z. Janos Huszar, Ambasador i Hungarisë, z. Vangjel Dule, Nënkryetar i Kuvendit, z. Aldo Bumçi, Zv. Kryetar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme, znj. Valentina Leskaj, Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian dhe të tjerë. Gjithashtu, diskutimet u pasuruan nga politikanë, analistë, media, akademikë, aktorë të shoqërisë civile, etj., nga rajoni dhe shtetet anëtare të BE-së.

Mesazhi mirëseardhës

Në fjalën përshëndetëse, Ambasadori i Greqisë në Shqipëri, z. Leonidas Rokanas u fokusua në situatën aktuale të Shqipërisë, duke shprehur se shteti ka treguar angazhim të fortë sidomos në aspektet politike, kulturore dhe historike dhe kohët e fundit ka dëshmuar vendosmëri në luftën kundër kimit të organizuar dhe drogës. Pritshmëritë e tij ishin optimiste në lidhje me vendimin e Këshillit të BE-së për statusin e vendit kandidat të Shqipërisë. Z. Rokanas theksoi qëllimin dhe rolin e Presidencës Greke në mbështetje të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, dhe në promovimin e paqes, stabilitetit, prosperitetit ekonomik, drejtësisë sociale dhe qëndrueshmërisë në rajon.

Situata aktuale e reformave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE

Në lidhje me këtë temë, z. Ditmir Bushati, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, u shpreh se statusi kandidat i Shqipërisë do të reflektonte një sinjal pozitiv stabilizimi në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor, por edhe një hap pozitiv për vetë Europën, e cila e konsideron procesin e zgjerimit si sfidë të vetën. Sipas znj. Klajda Gjoshë, integrimi europian ka ndihmuar Shqipërinë në thellimin e marrëdhënieve të saj me vendet anëtare dhe në përmirësimin e klimës politike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ajo përmendi marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si një fakt historik të bashkëpunimit. Znj. Majlinda Bregu, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian, deklaroi mbështetjen pa kushte të dhënë nga opozita lidhur me integrimin në BE dhe i dha peshë rolit të institucioneve, si instrumente kryesore për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Zgjerimi i BE-së: Po më pas? Presidencë Greke dhe Presidencë e ardhshme Italiane

Sesioni "Zgjerimi i BE-së: Po më pas?" moderuar nga gazetarja znj. Erjona Rusi, mbledhi së bashku z. Clive Rumbold, Charge d'Affaires, Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, z. Vassilis Maragos, Shef i Sektorit për Shqipërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit të Komisionit Europian, z. Massimo Gaiani, Ambasador i Rep. Italiane në Shqipëri. Z. Rokanas dhe z. Gaiani shprehën pikëpamjet e tyre respektive rreth Presidencës greke dhe Presidencës pasuese Italiane duke theksuar përkushtimin e tyre ndaj zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor.

*Massimo Gaiani "Shpresojmë që
lajmi pozitiv i marrjes së statusit
kandidat të Shqipërisë të jetë fillesa e
Presidencës Italiane"*

Si Greqia, ashtu edhe Italia janë përkrahëse të zgjerimit në Bashkimin Europian dhe ky qëndrim do të mbahet edhe nga Italia gjatë presidencës së saj. Sipas z. Maragos, pavarësia në gjyqësor

është thelbësore për integrimin e Shqipërisë në BE. Kështu, gjyqtarët shqiptarë duhet të jenë të pavarur dhe të besueshëm jo vetëm për të garantuar ligjin kombëtar, por edhe për të implementuar plotësisht ligjin e Bashkimit European. Meqenëse zgjerimi është një përgjigje e vullnetit publik, z. Rumbold e komentoi përfshirjen e shoqërisë civile në proces si



thelbësore. Ai tha se pa Bashkimit European rruga drejt demokratizimit, paqes dhe prosperitetit do të ishte një rrugëtimin i gjatë dhe i vetmuar për Shqipërinë.

Roli i Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritit europian: Në kërkim të fuqizimit

Më tej, diskutimi i moderuar nga z. Gjergji Vurmo, ekspert i çështjeve të BE-së, u përqendrua në rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritit. Z. Vangjel Dule, Nënkyetar i Kuvendit të Shqipërisë, theksoi nevojën për një konsensus mes pozitës dhe opozitës në Shqipëri për axhendën e përbashkët të integritit në BE. Për këtë arsye, përtej përbashkët në çështjet politike të ditës, elita politike duhet të tregojë maturi. Z. Aldo Bumçi, Nënryetar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme, prezantoi sfidat e ndeshura nga Kuvendi, dhe paraqiti trajtimin e procesit të integritit si një proces politik më shumë sesa teknik. Më tej, znj. Valentina Leskaj, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Integrimin European dhe znj. Albana Shtylla, Sekretare e përgjithshme e Kuvendit të Shqipërisë, përmendën rëndësinë e Zyrës së Deputetit në aspektin e transparencës dhe hapjes ndaj publikut. Ato shprehën nevojën për një forcim të funksionit kontrollues të Kuvendit.

Dhjetë vjet nga zgjerimi i madh: Mësimet e nxjerra nga ekonomia, demokratizimi dhe rëndësia e Ballkanit Perëndimor

Panelistët në sesionin e katërt të Konferencës Ndërkombëtare, z. Janos Huszar, Ambasadori i Hungarisë, z. Remzi Lani, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Shqiptar i Medias, znj. Edith Harxhi, Drejtore Ekzekutive e Albanian Policy Center dhe z. Ioannis Armakolas, Shef i Programit të Europës Jug-Lindore, ELIAMEP diskutuan mbi mësimet e nxjerra për ekonominë dhe demokratizimin në dhjetë vjet nga zgjerimi më i madh. Z. Lani dha një shpjegim të rrugëtimit të Ballkanit Perëndimor duke konsideruar aspekte historike, gjeografike dhe të demokracisë.

Armakolas

“Nuk ka alternativë tjetër për Ballkanin përveç BE-së”

“Të gjithë e dimë se procesi i zgjerimit në Ballkanin Perëndimor është plot vështirësi. Ne vazhdojmë me zgjerimin për inerci, dhe unë mendoj që inercia është e rëndësishme në situata krizash,” tha z. Ioannis Armakolas. Znj. Harxhi u shpreh se nëse trajtimi i BE ndaj shteteve të Ballkanit Perëndimor do të ishte i njëjtë, atëherë me shumë mundësi do të shihnim këto shtete të bashkëpunonin dhe të lobonin së bashku në Bruksel.

Përtej Axhendës së Selanikut: Transport, Energji, Ndërlidhje dhe Edukimi / Perspektiva e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor në IPA II

Seanca e fundit “Përtej Axhendës së Selanikut: Transport, Energji, Ndërlidhje dhe Edukimi / Perspektiva e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor në IPA II të ardhshme” u hap nga z. Yngve Engström, Kreu i Operacioneve, Delega-

TAP ka luajtur rol në procesin e pranimit dhe po forcon bashkëpunimin dhe fqinjësinë mes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë

cioni i BE-së në Shqipëri, i cili theksoi se tashmë mbështetja financiare IPA II nuk diferencon vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë për në BE. Asistenca financiare varion nga strategjia e çdo shteti Pavarësisht krizës ekonomike, ka një përkushtim të konfirmuar për mbështetjen e procesit me pothuajse po të njëjtat nivele si gjatë shtatë viteve të fundit. Folësit e ftuar, z. Ilir Bejtja, Zëvendësministër i Energjisë, z. Erion Luçi, Zëvendësministër i Financave, znj. Enida Bezhani, Këshilltare e Punëve të jashtme, TAP AG, nën moderimin e znj. Ledina Gjikhuri, u fokusuan në njohuritë e përfitimeve nga mbështetja e WBIF deri më sot në Shqipëri. Ata shpjeguan efektet që TAP ka në spektrin e gjerë në Shqipëri, Greqi dhe Itali dhe dobitë e tij në forcimin e bashkëpunimit në rajon. Aktiviteti u shoqërua nga diskutime të ndryshme mes panelistëve dhe pjesëmarrësve.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2014

Rrugëtimi drejt BE-së, çfarë jep dhe çfarë merr Shqipëria

...vijon nga faqja 1 >>

Shqipëria dhe shqiptarët janë pjesë e pandashme e mozaikut të vendeve dhe popujve të kontinentit evropian. Qenësia dhe përkatësia e gjithanshme e shqiptarëve dhe modeli i shkëlqyer i suksesit të demokracive të vendeve të Europës Perëndimore, kanë frymëzuar aspiratën mbarë popullore që



Shqipëria të mos jetë thjesht një pjesë e natyrshme e kuadrit gjeografik, gjenetik, historik dhe tradicional të kontinentit evropian, por të bëhet hallkë integrale e bashkësisë aktuale dhe të identitetit të ri evropian, të përthithë dhe të përçojë vlerat më të mira si dhe të kontribuojë për ruajtjen, respektimin e mëtejshëm të tyre.

Që prej rënies së sistemit komunist, shtyja kryesore

për vendosjen e lidhjeve me Europën e Bashkuar, erdhi vertikalisht nga poshtë – lart, deri tek maja e piramidës shtetërore, me një përcaktim të qartë të kursit që do të ndiqej me konsekuencë nga të gjitha qeveritë shqiptare deri në aderimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Duke filluar që nga nënshkrimi i marrëveshjes të Tregtisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në vitin 1992 dhe deri në vitet e fundit, Shqipëria është kthyer në një faktor pozitiv stabilizues në rajonin e trazuar të Ballkanit dhe ka treguar se mund të jetë një aleat tepër i rëndësishëm për partnerët ndërkombëtarë.

Procesi i integritit evropian përbën një nga sfidat më të mëdha për ne në 23 vitet e fundit dhe marrja e statusit shërben si inkurajim i mëtejshëm për nisjen e negociatave për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian. Shqiptarët mbeten një komb entuziast sa i takon anëtarësimin. Nëse do të mbahej një referendum lidhur me integritin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, rezultatet do të tregonin se afërsisht 90% e shqiptarëve do të votonin në favor të një bashkimi të mundshëm me vendet e tjera të bllokut evropian. Arsyeja e këtij eurofilizmi lidhet me faktin se shqiptarët e shohin integritin si zgjidhjen e shumë çështjeve të brendshme në vendin e tyre.

Perspektiva europiane e Shqipërisë

Shqipëria, që me njohjen si një vend kandidat potencial në samitin e Zagrebit më 24 nëntor të vitit 2000, ka bërë një rrugëtim të gjatë drejt integritit në Bashkimin Evropian. Mbyllja e negociatave dhe nënshkrimi i Marrëveshjes të Stabilizim Asocimit (MSA), të nisura më 31 janar 2003, midis Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian nga ana tjetër në Qershor 2006, shënon fillimin e një epoke të re për zhvillimin e politikave institucionale, ligjore, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, me qëllim harmonizimin e tyre me standardet europiane. Nënshkrimi i MSA-së përveç detyrimeve në planin politik, ligjor, ekonomik dhe institucional për Shqipërinë do të shoqërohet edhe me një kuadër të ri të marrëdhënieve BE-Shqipëri, duke shënuar stadin më të avancuar të kësaj marrëdhënieje.



Progreset e konsiderueshme të bëra nga të gjithë faktorët e shoqërisë shqiptare, sollën si rrjedhojë nisjen e procesit të liberalizimit të regjimit të vizave. Në lidhje me këtë, më 15 dhjetor 2010, hyri në fuqi kalimi pa nevojën e vizës të qytetarëve shqiptarë në zonën Shengen. Më 28 prill 2009, vendi i vogël i Ballkanit Perëndimor aplikoi për anëtarësimin në familjen e madhe të Europës së Bashkuar dhe më 5 dhjetor 2013 Parlamenti European miratoi një rezolutë, në të cilën i bënte thirrje shteteve anëtare që krahas pranimin të aplikimit të vendit tonë, formalisht ta pranonin Shqipërinë si një vend kandidat dhe si rrjedhojë t'i jepnin statusin. Megjithatë disa shtete si Danimarka dhe Holanda, shfaqën kundërshtitë e tyre ndaj dhënies së statusit të vendit kandidat, derisa Shqipëria të tregojë se është e aftë të çojë më tej progreset e saj të fundit. Si rrjedhojë, Këshilli i Bashkimit European, në mbledhjen e tij, vendosi shtyrjen e vendimit përsa i përket statusit kandidat deri në qershor të vitit 2014.

Përfitimet e Shqipërisë në rast se do të integrohet në Bashkimin European

Integrimi European do të garantojë stabilitetin dhe prosperitetin, të cilat do të mbështeten në asistencën financiare përmes fondeve strukturore, duke ofruar një dritare të re në fushën e biznesit për investimet e huaja në Shqipëri (heqja e kufizimeve në lidhje me lëvizjen e kapitaleve si dhe lëvizja e lirë e kapitaleve në lidhje me investimet direkte, liberalizimi i ofrimit të shërbimeve, vendosja e shoqërive tregtare në vendet respektive të palëve kontraktuese dhe ofrimi i shërbimeve). Anëtarësimi i plotë në standardet europiane do të sjellë përmirësime të mëdha jo vetëm në fushat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, luftës ndaj korrupsionit dhe administrimit e financave publike por gjithashtu edhe në fusha të tjera si mbrojtja sociale, siguria ushqimore dhe mjedisore, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Bashkimi European është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, ku 80% e eksporteve

në Shqipëri shkojnë në BE dhe 65% e importeve të saj vijnë nga BE. Një integrim i plotë në BE do të thotë që produktet shqiptare do të kenë akses në tregjet e mëdha, pasi janë hequr të gjitha detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me këto kufizime, duke stimuluar në këtë mënyrë inovacionin, sipërmarrjen dhe diversifikimin në ekonominë shqiptare. Integrimi European do t'iu ofrojë qytetarëve shqiptarë mundësi të reja udhëtimi, studimi dhe punësimi në Bashkimin European.

Përfitimet që do të ketë BE në rast se Shqipëria i bashkohet familjes së madhe Europiane

Pavarësisht se Shqipëria është një vend i vogël dhe i varfër, mund të ofrojë një sërë përfitimesh për BE-në të tilla si në fushën e turizmit, pasi vendi gëzon një pozitë të favorshme gjeografike; apo në fushën kulturore, ku Shqipëria ka një pasuri të larmishme të trashëgimisë kulturore, një pjesë e së cilës mbrohet nga UNESCO.

Ekonomia shqiptare është kryesisht një ekonomi bujqësore, si një ndër burimet kryesore të punësimit dhe të ardhurave vjetore (rreth 20% të GDP-së), mbi të gjitha falë financimeve të investitorëve të huaj, duke qenë se pjesa më e madhe e popullsisë është e vendosur në zonat rurale. Pra, sektori i bujqësisë është një tjetër sektor që zë një vend mjaft të rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Një bujqësi e zhvilluar do të thotë një Shqipëri konkurruese në Europë me anë të produkteve të saj, të cilat janë në përmbushje të plotë të të gjithë standardeve europiane, përsa i përket sigurisë si të produktit ashtu edhe të konsumatorit.

Anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në NATO më 2 prill 2009, e ka bërë Shqipërinë një nga partnerët më të besueshëm të Europës Perëndimore në rajonin e trazuar dhe të ndarë të Ballkanit. Pra, siç shihet ky vend i vogël ballkanik është kthyer në një faktor pozitiv në fushën e sigurisë dhe të bashkëpunimit bilateral apo multilateral në fushën ushtarake, jo vetëm në Ballkan por edhe në arenën ndërkombëtare. Por Shqipëria ka një cilësi të veçantë për tu krenuar në botë, e cila është toleranca dhe harmonia midis komuniteteve fetare në vendin tonë, ku shumica e popullsisë janë myslimanë.

Gjithashtu Shqipëria ofron një siguri juridike dhe fiskale për çdo investitor të huaj që ka dëshirë dhe shpreh interesin për të. Përafrimi i legjislacionit shqiptar ma standardet europiane e ka lehtësuar mjaft procedurën burokratike të politikës fiskale dhe financiare.

Konkluzione

Zyrtarët europianë janë shprehur se e ardhmja e Shqipërisë është brenda Bashkimit Europian dhe se Shqipëria i ka të gjitha kapacitetet për të përmbushur kriteret e integritetit. Procesi i integritetit, si prioritet kombëtar i çdo qeverie, ka bërë të mundur që Shqipëria të jetë sot më pranë Europës. Gjithëpërfshirja në këtë proces është themelore për të garantuar më shumë siguri dhe progres për të gjithë qytetarët. Marrja e statusit do të thotë se njihet angazhimi i Shqipërisë për të përmbushur reformat e kërkuara si lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reforma në sistemin gjyqësor, reforma në administratën publike, të drejtat e njeriut të Romëve dhe të komunitetit LGBT, reforma të cilat do të rrisin besimin në ekonominë shqiptare dhe në sistemin politik të saj.

Duke u nisur nga fakti se procesi i integritetit nuk është një proces i zakonshëm negociimi diplomatik, nuk duhet të jetë një ekskluzivitet i vetëm i një individi apo i një grupimi të caktuar individësh, por duhet të ketë një konsensus gjithëpërfshirës rreth këtij projekti kombëtar. Pra ky projekt ka nevojë jo vetëm për përfshirjen e qeverisë por edhe të faktorëve të tjerë si institucionet shtetërore, të partnerëve sociale dhe të shoqërisë civile.

*Ardi Meçi,
Eseja Fituese e Konkursit
në Kuadër të Ditës së Europës 2014*

A ekziston e drejta për shkëputjen e Skocisë dhe Katalonjas prej vendeve përkatëse?

...vijon nga faqja 1 >>

e një referendumi për këtë çështje. Sondazhet e realizuara mbi: "A duhet që Skocia të jetë një vend i pavarur?" tregojnë se "po-ja" vështirë se mund të fitojë numrin më të madh të votave.

Në ndryshim nga Skocia, ku vetëm 1% e Skocezëve mund të flasin Galisht, në Katalonja, identiteti nacional forcohet nga fakti se shumica e rezidentëve të rajonit mund të flasin gjuhën Katalanase aq mirë sa atë Spanjolle. Si rezultat i kësaj, mbështetja për pavarësinë e Katalonjas duket se është shumë më e gjerë, me më shumë se gjysmën e vendasve të rajonit. Parlamenti Spanjoll votoi masivisht kundër lejitimit të qeverisë Katalane për të mbajtur referendum për pavarësi. Gjithsesi, Artur Mas, President i qeverisë rajonale Katalonase, është zotuar që ta çojë deri në fund këtë proces.

Lind pyetja "Në rast se një shumicë votuesish në një rajon të veçantë të një vendi favorizojnë pavarësinë, a do të thotë kjo që ata kanë të drejtën për shkëputje?"

Po sikur shkëputja e një rajoni të lërë pas një shtet jo më të shëndetshëm? Brenda BE-së, ky është një problem i shpërfillshëm, duke marrë parasysh se shtetet e vogla- në teori- mund të përfitojnë nga tregu i lirë brenda Bashkimit; por, jashtë Bashkimit, situata e shtetit të mbetur mund të jetë serioze. Shkëputja e Skocisë, do i hiqte Mbretërisë së Bashkuar të ardhura të konsiderueshme nga nafta e Detit të Veriut, ku mbështetet ekonomia e pavarësisë skoceze. Po ashtu, Spanja mund të vuante nga humbja e kontributit të gjerë që Katalonja sjell në ekonominë spanjolle.

Shkeljet e të drejtave të njeriut, të shkaktuara ose të lejuara nga një qeveri kombëtare, mund t'i japin shtysë asaj që zakonisht njihet si e drejtë ndreqëse për shkëputje për vendasit e atij rajoni.

Ky ishte rasti i shkëputjes së Bangladeshit nga Pakistani, dhe i tillë ishte rasti kur NATO mbështeti pavarësinë e Kosovës prej Serbisë. Por kjo nuk është njëllloje zbatueshme për Skocinë ose Katalonjan; ashtu siç, pavarësisht nga propaganda Ruse, nuk është as rasti i rajoneve të Ukrainës me shumicë etnike ruse.

Në rast se Skocia dhe Katalonja arrijnë të fitojnë pavarësinë, kjo do të ndodhë vetëm nëse MB dhe Spanja do e lejojnë. Të gjitha shtetet kanë interes për stabilitet, prandaj është e vështirë të imagjinohet se si shtetet e tjera do të mund të njihnin një rajon i cili, pasi ka qenë pjesë e një shteti për shumë shekuj, vetë-deklarohet i pavarur pa konsensusin e vendit prej të cilit shkëputet. Gjithashtu, Bashkimi European vështirë se mund të pranojë Skocinë ose Katalonjan si vende anëtare në rast se MB ose Spanja refuzojnë kërkesat e tyre për pavarësi. Në fakt, Presidenti i Komisionit European, Jose Manuel Barroso, ka thënë se BE-ja mund të refuzojë aplikimet e Skocisë dhe Spanjës, ose të paktën ti vonojë gjatë edhe nëse MB dhe Spanja pranojnë pavarësinë e tyre. Natyrisht, pa anëtarësim European, Skocia dhe Katalonja do të zhyteshin në pasiguri ekonomike.

Roli i një referendumi në një rajon që lufton për shkëputje, mund të shërbejë si një formë përpjekjeje për të bindur qeverinë e vendit ekzistues tu përgjigjet ankesave të rajonit aspirant për shkëputje. Pjesëmarrja e madhe që tregon një shumicë që mbështet pavarësinë do ishte një mënyrë për të thënë: "Jemi aq të pakënaqur me gjendjen ekzistuese, sa pjesa më e madhe favorizojmë shkëputjen. Në qoftë se doni të qëndrojmë, ju duhet të adresoni ankesat tona që kanë çuar në kërkesën tonë për shkëputje".

Project Syndicate, korrik 2014

Kartolina nga BE-ja

Reflektime pas zgjedhjeve parlamentare në BE 22-25 maj 2014

Pse zgjedhjet ishin ndryshe këtë herë?

Sipas Traktatit të Lisbonës numri i vendeve në Parlament është reduktuar në 751, the krerët e shteteve dhe qeverive duhet të merrnin parasysh rezultatit për zgjedhjen e Presidentit të ardhshëm të Komisionit të BE-së.

Më një pjesëmarrje që u rrit vetëm pak (0.09%), Parlamenti European dështoi të gjeneronte interesin

e votuesve. Për të injektuar një qëllim më të madh të votimit dhe për të rritur kështu përfshirjen e qytetarëve, partitë politike parashtruan kandidatët e tyre për rolin e presidentit të Komisionit.



Ky vit i zgjedhjeve nxorri në dukje partitë kundërshtare të projektit European, veçanërisht në Francë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Problematika më e madhe e këtyre zgjedhjeve ishte fitorja e ekstremistëve të djathtë në Francë, me në krye Marine Le Pen dhe euroskeptikëve në Britaninë e Madhe. Kjo ishte hera e parë në më shumë se një shekull që në zgjedhjet kombëtare nuk kanë fituar Partia Konservatore apo Partia Laburiste në Britani.

Rezultatet e zgjedhjeve

Sipas rezultateve të zgjedhjeve, Partia Popullore Europiane e qendrës së djathtë ka marrë numrin më të madh të vendeve në parlament duke zënë 208 vende, ndërkohë partitë socialiste dhe demokratike të qendrës së majtë kanë në bllok 186 vende. Partitë radikale të majta dolën mirë me krizën që ka goditur shtetet jugore të Eurozonës, por në **Greqi** ekstremistët e djathtë kanë rritur mbështetjen e tyre. Në **Spanjë**, Partia Popullore ruajti kryesinë, por së bashku me opozitën socialiste, pësuan humbje të thella duke humbur respektivisht 8 dhe 9 vende në parlament. Opozita socialiste në **Portugali** arriti të merrte drejtimin pas 3 vjetësh të vështira. Surprizuese ishin rezultatet në **Itali**, ku ka kryesuar Partia Demokratike e qendrës së majtë, pasuar nga Lëvizja "5 Yje" euroskeptike e Beppe Grillo. Ndërkohë Forca Itali e Silvio Berlusconi renditet e treta. Rëndësia e zgjedhjeve parlamentare europiane u eklipsua nga zgjedhjet kombëtare në **Belgjikë**, ku nacionalistët fiamingë fituan vendin

e parë. Kryeministri Elio Di Rupo, një socialist nga pjesa frëngjisht-folëse e vendit, dha dorëheqjen. Euroskeptikët e Partisë së Lirisë në Hollandë ranë nga vendi i dytë në vendin e katërt. Hollandezët i dhanë një vend në Parlamentin Europian Partisë për të drejtat e kafshëve për herë të parë. Gjermania vjen e stabilizuar. Bashkimi Kristian-Demokrat i Gjermanisë dhe Bashkimi Social-Kristian i Bavarisë, partitë e qendrës së djathtë të Angela Merkel ruajtën epërsinë e tyre në zgjedhje. Partia Social Demokratike, pjesë e koalicionit me to, pati një rritje të konsiderueshme. Zgjedhjet në Danimarkë u kryesuan nga Partia kundër imigracionit të njerëzve, e cila fitoi 4 vende. Suedia zgjodhi deputeten e parë europiane nga Nisma Feministe, e vetmja parti feministe formale në PE. Partia Euroskeptike e Finlandezëve të Vërtetë fitoi 2 vende në PE, duke rezultuar kështu më poshtë parashikimeve. Polonia, shteti me numrin më të madh të vendeve në PE nga shtetet e anëtarësuar rishtazi (51), u ndesh me zvogëlim të numrit të vendeve të fituara nga Partia Platforma Qytetare dhe nga opozita, Partia për Ligj dhe Drejtësi, konkretisht 19 vende secila. Në Hungari, partia e kryeministrit Viktor Orban kryesoi duke fituar 12 vende në PE. Në Bullgari Partia konservatore opozitare Gerb mundi Partinë Socialiste në zgjedhjet europiane

Presidenti i Parlamentit Europian

Martin Schulz është presidenti i parë në historinë e parlamentin europian që është zgjedhur për një term të dytë për dy vjet e gjysmë. Eurodeputeti gjerman



58 vjeçar do të drejtojë Parlamentin Europian deri në janar 2017. Pas rezultatit të votimit, Schulz falenderoi eurodeputetët që besuan te ai dhe he theksoi se deputetët duhet të " Nëse BE-ja mbron njerëzit, ne do

të fitojmë besimin e qytetarëve, pavarësisht origjinës apo gjinisë. Rregulli i respektit dhe dinjitetit njerëzor duhet të udhëheqë në çdo gjë që bëjmë dhe unë e di se një shumicë e madhe do të ndajnë këtë mendim. Le të punojmë dhe të kemi debat konstruktiv!"

Jean- Claude Juncker si President i Komisionit Europian


Zgjedhjet parlamentare të majit e kanë mbuluar me një hije të zymtë sfidën e integritit. Lufta tanimë është për të ardhmen demokratike të Bashkimit Europian dhe procesi i zgjedhjes së presidentit të KE-së e tregon sa reale është bërë kjo luftë. Në maj, liderët e BE-së, përfshirë znj. Merkel, thanë se do të kërkojnë në një gamë të gjerë kandidatësh për të zgjedhur presidentin e KE-së dhe do të merren edhe me çështje të tjera si vendosja e më shumë femrave në poste të larta, si dhe mirëpritja e kërkesave të shteteve anëtare të bllokut. Pavarësisht kundërshtimit të ashpër të kryeministrit britanik David Cameron, liderët e Bashkimit Europian votuan për të emëruar Jean-Claude Juncker në pozicionin e presidentit të Komisionit Europian.

Përfundimi i këtij votimi tregoi qartë se shtetet anëtare zgjodhën të përkrahin Gjermaninë, fuqia ekonomike më e fortë në Europë, dhe jo Britaninë e Madhe e cila pritet të largohet nga Bashkimi Europian në vitet në vazhdim. Presioni në rritje nga çështja e zgjedhjes së Juncker mund të përshpejtojë largimin e Britanisë së Madhe. Drejtimi që do të marrë Britania e Madhe do të varet nga zgjedhjet elektorale të ardhshme. Cameron është shprehur se, nëse i fiton zgjedhjet, do të mbajë një referendum në 2017 për të vendosur nëse Britania e Madhe do të qëndrojë apo do të dal nga blloku.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2014

Italia merr Presidencën e Këshillit të Bashkimit Europian: Ja programi dhe prioritetet

Pas Greqisë, Italia mori me rotacion presidencën gjashtë mujore të Këshillit të Bashkimit Europian. Që nga viti 1959 e gjer sot Italia ka mbajtur 11 kryesime, duke rezultuar në një nga shtetet anëtare më me përvojë në presidencën e Këshillit. Kryeministri



i Italisë Matteo Renzi ka prezantuar programin e qeverisë së tij për periudhën 1 korrik deri më 31 dhjetor 2014, ku prioritete kyç janë: zhvillimi ekonomik dhe punësimi, ushtrim i plotë i të drejtave qytetare, dhe një politikë të jashtme të BE-së më efektive.

Europa për punësim dhe zhvillim ekonomik

Presidenca Italiane synon të vendosë në qendër të politikave europiane zhvillimin dhe punësimin dhe të përcaktojë një kornizë ekonomike e cila do të inkurajojë reforma strukturale në shtetet anëtare. Fokusi i iniciativave të zhvillimit do të jetë në “rilindjen industriale”, me një përqendrim të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) ashtu si dhe në politikat për energjinë dhe klimën për 2030. Presidenca italiane do të punojë për të forcuar Bashkimin Ekonomik dhe Monetar Europian, e për të mbështetur investime në sektorë të rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve tanë si: mbrojtja e mjedisit, infrastruktura dhe shërbimet dixhitale. Presidenca italiane do të përqendrohet në çështje të qëndrueshme të zhvillimit edhe nëpërmjet bashkëpunimit pozitiv me Expo Milano 2015, tema kryesore e së cilit është “Ushqimi i planetit. Energji për jetën”.

Europa më afër qytetarëve: hapësirë për demokraci, të drejta dhe liri

Përgjegjësia, dixhitalizimi, transparenca dhe reduktimi i burokracisë janë përgjigjet e atyre të cilët urojnë që Europa të jetë më afër qytetarëve. Është shumë e rëndësishme të sigurohet funksionimi i rregullt dhe bashkëpunimi besnik midis institucioneve në mënyrë që këto të fundit të mund të funksionojnë shpejt dhe efektivisht. Presidenca Italiane do të promovojë një rol më aktiv të Bashkimit Europian në fusha si mbrojtja e të drejtave themelore, imigrimi dhe politikat e strehimit. Në këtë kontekst, Presidenca italiane ka për qëllim të punojë për rritje të solidaritetit në një nivel europian dhe të promovojë një politikë europiane imigrimi.

Një shtysë e re për politikën e jashtme të Bashkimit Europian

Pranvera arabe dhe kriza Ukrainase i treguan Europës se nuk mund të injorojë ngjarje të tilla historike. Italia do të përpiqet që aksioni i jashtëm i BE-së të jetë i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i pajisur me mjetet e nevojshme për të adresuar sfidat globale dhe rajonale. Emergjencia për imigrimin e detyron Europën që të përvetësojë instrumente dhe politika të përbashkëta në mënyrë që ky fenomen kryesor i kohëve të sotme të trajtohet më së miri. Zgjerimi i BE-së është një prioritet strategjik i Presidencës Italiane, si rrjedhojë do të inkurajohen negociatat e zgjerimit me Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, presidenca do të mbështesë negociatat tregu dhe investime të dyanshme me partnerë strategjikë dhe ekonomi në zhvillim siç janë vendet aziatike. Këto negociata do të jenë në fokus të samitit Azi-Europë në 16-17 Tetor.

Italia2014.eu, korrik 2014

Festimet e Ditës së Europës 2014

Në kudër të Ditës së Europës Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, organizuan aktivitetin “Simulimi i Institucioneve të BE-së”. Protagonistë ishin studentë të përzgjedhur, të cilët performuan si përfaqësues të Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit Europian. Studentët u njohën nga afër me rregulloren e vendimmarrjes së institucioneve të BE-së dhe procedurat negociuese. Studentët më të dalluar u vlerësuan me çmime nga një juri e përbërë nga ekspertë të fushës së Integritimit Europian dhe fushës akademike.



Erdjol Yzeiri: European Means to Be Free

Gjatë javës së Europës, EMA organizoi forumin “Procesi i Integritimit të Shqipërisë në BE” me të ftuar zv. Ministrin e Integritimit Europian z. Gentian Elezi, duke i ofruar mundësi studentëve të njihen më afër me sfidat e Shqipërisë drejt Integritimit,

programin e hartuar nga qeveria mbi 5 prioritetet kyçe të Shqipërisë për hapjen e negociatave, angazhimin e institucioneve për raportimin para statusit, nevojën për bashkëpunim dhe angazhim të aktorëve pjesëmarrës në proces etj. Disa nga çështjet e ngritura për diskutim nga studentët ishin mbi kostot e Shqipërisë dhe vështirësitë ekonomike për përballjen me konkurrencën europiane, mbi reformën administrative ne vend, rëndësinë e një lobimi më efektiv, luftën ndaj korrupsionit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, etj.

Në sajë të bashkëpunimit të vendosur me Lëvizjet Europiane në Finlandë, Irlandë dhe Slloveni, EMA mirëpriti në Tiranë përfaqësues të këtyre organizatave të cilët ndoqën nga afër festimet e javës së Europës. Liisa Ketolainen nga EMFinland u shpreh kështu për eksperiencën e saj në Tiranë: *“E kam shijuar tërësisht qëndrimin tim në kryeqytetin shqiptar. Nga dikush që vjen nga një shtet euroskeptik si Finlanda, ishte surprizuese të dëgjoje se shumica e vendasve në Shqipëri e konsideronin aq të dëshirueshëm anëtarësimin në BE. Shqipëria i ka rezistuar një periudhe të gjatë izolimi*



Ervin Gjokutaj: Old Man Engraving

komunist, dhe tashmë pas shumë ndryshimesh në vend, unë besoj se integrimi në BE i vendit do të vazhdojë e do thellohet. Vendet që kam vizituar, njerëzit që kam patur fat t'i takoj më kanë hapur sytë për një vend, për të cilin s'dija shumë paraprakisht, dhe më kanë rritur dëshirën e kuriozitetin të kthehem sërish.”

Ndërkohë që festimet vazhdonin në Helsinki, por të përqendruara më shumë në zgjedhjet parlamentare europiane, vullnetarja e EMA-s ndan ekperiencën e saj në kryeqytetin finlandez: *“Praktikisht EM Finland po merret me fushatën zgjedhore të disa partive që kanë shprehur dëshirën të propagandohen, kështu që lëvizin përditë në një qytet të ri. Është një fushatë e thjeshtë, më tepër se për partitë në fjalë, propagandohet votimi si një e drejtë dhe një detyrim qytetar ndaj vendit. Kjo është një nismë shumë qytetare dhe e moralshme, dhe me aq sa pashë mendoj se lëvizja po bën një punë produktive.*

Finlandezët, ndryshe nga ç'i përshkruajnë, janë të afrueshëm dhe gazmorë. Ndryshe nga qytetet e tjera turistike, Helsinki nuk kishte as madhështinë e Romës, as romantizmin e Parisit. Ashtu sikurse dhe banorët, qytetin e gjeta të rregullt, të disiplinuar por miqësor edhe pse në pamje të parë të ftohtë”.



Doris Rapi: Unity in Diversity



Edi Sara: Pure Natural Goods Within Europe

Dita e Europës s'mund të ishte e njëjta pa Konkursin Europian të Fotografisë, ku secili i pasionuar kishte mundësinë të shprehte çfarë domethënie kishte të qenit european për të. Shqipëria u përfaqësua denjësisht,

pasi në kategorinë Juvenes (nën 18 vjeç) fotoja e një gjimnazisteje shqiptare Doris Rapi doli e para, dhe në kategorinë Europa (mbi 18 vjeç) ndër 10 fotografitë më të mira janë përzgjedhur ato të Erdjol Yzeiri, Ervin Gjokutaj dhe Edi Sara nga Shqipëria.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2014

Qarkullim postesh nga institucionet e BE-së drejt sektorit privat

Një pjesë e vogël ish-zyrtarësh të BE-së dhe një deputet i PE pozicionohen në vende pune në sektorët e industrisë për të cilët ata kanë nxjerrë ligje gjatë mandatit të tyre. Rastet nxjerrin në pah atë që ekspertët pro-transparencës e përshkruajnë si “derë rrotulluese”, ku hartuesit e politikave janë të punësuar pranë kompanive private të interesuara ndaj legjislacionit të BE-së.

Tetorin e kaluar, dy firma konsulence punësuan Joao Pacheco. Pacheco ishte në atë kohë zv.drejtor i Komisionit European për Bujqësinë. Sot, ai është drejtor për tregjet europiane AFJ dhe bashkëpunëtorët në SHBA. Ai është gjithashtu president i firmës konsultuese JSPacheco-International me qendër në Bruksel. I pyetur, Komisioni është shprehur se po heton për Pacheco, por dëshiron të ruajë “prezumimin e pafajësisë” përpara se të bëjë ndonjë akuzë. “Kjo procedurë është ende në vazhdim e sipër dhe për këtë arsye ne nuk jemi në gjendje të japim ndonjë koment të mëtejshëm”, tha një zëdhënës i komisionit në email. Rasti Pacheco u ngrit fillimisht gjashtë muaj më parë nga Korporata Europiane e Vëzhgimit (CEO) me bazë në Bruksel.

Raste të tjera të CEO përfshijnë ish-zyrtarët e Komisionit Per Hellstrom dhe Peter Faross. Hellstrom kryesoi shkriret për mjedisin dhe energjinë në konkursin për drejtoritë e përgjithshme deri në shkurt, kur ai mori leje të përkohshme për të punuar pranë Apple. Komisioni thotë se Hellstrom u largua për arsye personale. Ai vë në dukje se Hellstrom lejohet të angazhohet në aktivitete jashtë Komisionit gjatë pushimit të tij, për sa kohë ai nuk përfshihet në asnjë lobim ose aktivitet përkrahës në Komision.

Faross ishte zv.drejtori i Përgjithshëm në Drejtorinë për Energjinë deri në shtator. Ai kishte një karrierë 30-vjeçare në Komision. Disa muaj më vonë, ai u bë Sekretari i përgjithshëm i UEAPME me bazë në Bruksel, që përfaqësojnë bizneset e vogla dhe të mesme. Komisioni e autorizoi këtë veprim për sa kohë që Faross nuk angazhohet në lobim për çështjet e energjisë deri në një vit. “Duket qesharake të mendosh se të ndalosh sekretarin e përgjithshëm të llojë me kolegët e tij të vjetër në çështjet e energjisë është e

mjaftueshme për të parandaluar rrezikun e konfliktit të interesave”, Komisioni thotë se propozimi i COE për të zgjatur ndalimin e lobimit më shumë se 12 muaj është i tepruar. “Ajo gjithashtu do të shkelte një nga të drejtat themelore që ne të gjithë kemi: e drejta e punësimit, siç parashikohet në kartën e të drejtave themelore”, tha Komisioni.

Deputetja hollandeze e Qendrës së Djathtë Corien Wortmann-Kool, ishte zv.kryetare e Komisionit Parlamentar për Çështjet Financiare, Ekonomike dhe Mjedisore. Ajo tani është anëtare e bordit mbikëqyrës në Aegon NV, një kompani multinationale me qendër në Hagë për sigurimin e jetës, pensionet dhe menaxhimin e aseteve. “Ajo është në bordin mbikëqyrës, i cili mblidhet vetëm një herë në tre muaj, kështu që teknikisht nuk është një punë me kohë të plotë”, tha zyra e saj. Aegon NV, nga ana e saj, thotë se ata e punësuan Wortmann-Kool kryesisht për shkak se ajo ishte anëtare e Parlamentit European, si edhe për përvojën e saj të gjerë me organizatat politike, qeveritare dhe sociale. Rregullorja e PE i mundëson Wortmann-Kool, si një ish-deputete, akses të pakufizuar në asamble për pjesën tjetër të jetës.

CEO thotë se ky rast thekson nevojën e Parlamentit për të vendosur rregulla për korrigjim të praktikës. “Ne kemi një problem me faktin se nuk ka rregulla për efektin e “derës rrotulluese” në PE”, tha eksperti i politikës në CEO, Vicky Cann.

EurActiv, qershor 2014

BE-ja duhet të bëjë “më shumë me më pak” në vitin 2015

Komisioneri i buxhetit të bllokut european, ndërsa paraqiste planet e shpenzimeve të BE-së për vitin 2015, deklaroi se Europa do të duhet të bëjë më shumë me më pak. Nëse miratohen nga eurodeputetët dhe ministrat e qeverive, shpenzimet do të jenë 2,5 bilion € më pak se në vitin 2013, duke reflektuar shkurtimin prej 3% të shpenzimeve të BE-së ndërmjet 2014 dhe 2020.

Projektet e investimeve publike të BE-së duke përfshirë skemat e garancisë së të rinjve janë në listë për të patur rritjen më të madhe në të holla, duke marrë nga

Komisioni 15,6 bilion €, një rritje prej 29.5% për këtë vit. Nga ana tjetër, financimi strukturor për rajonet më të varfra të bllokut përballet me shkurtimin më të madh prej 5% por, me një parashikim prej 51,6 bilion €, do të mbetet elementi më i madh i shpenzimeve.



Gjithashtu, stafi në Komisionin Europian do të pësojë një shkurtim me mbi 1000 punonjës.

“Kemi të bëjmë me më shumë angazhime dhe me më pak para”, tha komisioneri Janusz Lewandowski. “Disa shtete anëtare nuk e marrin parasysh se premtimet politike kanë pasoja financiare”, shtoi ai.

Më shumë se 57 bilion €, ekuivalente me rreth 40% të buxhetit të përgjithshëm, do të mbulojë faturat e papaguara nga cikli i mëparshëm buxhetor 2007-2013. Ndërkohë, Lewandowski nuk pranoi të flasë për të ardhmen e tij, edhe pse u zgjodh si deputet i PE në Poloni. Ai është i vendosur të sigurojë një mandat të dytë si komisioner i vendit të tij, edhe pse ministri i jashtëm Radek Sikorski është menduar si një zëvendësim i mundshëm për shefin e punëve të jashtme të BE-së dhe nënkryetaren e komisionit Catherine Ashton.

EU Observer, qershor 2014

Në pritje të aderimit

SHBA, BE dhe OSBE i bëjnë thirrje Serbisë për lirinë e medias

Pas rasteve të fundit të censurimit në mediat serbe, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare kanë theksuar rëndësinë e lirisë së shprehjes.



Michael Davenport, kreu i Delegacionit të BE-së në Serbi, tha se asnjë vend demokratik i cili synon të bëhet pjesë e Bashkimit Europian nuk duhet të vendosë kufizime apo presion mbi lirinë e shprehjes. Sipas tij, janë tre fenomene që ndikojnë në lirinë e shprehjes në Serbi: autocensura, pirateria e faqeve të internetit dhe frikësimi i individëve të ndaluar dhe të arrestuar më parë për komente në rrjetet sociale. Sipas tij, përgjegjësia për probleme të tilla në media në Serbi lidhet me qeverinë, mediat dhe me ekspertët online ose blogerët.

SH.B.A i dhanë mbështetjen e tyre popullit serb nëpërmjet ambasadorit të SH.B.A në Serbi, Michael Kirby. “Ju keni mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për të shprehur lirshëm mendimin tuaj dhe ne do t’ju gjendemi për t’ju mbrojtur në Serbi dhe jashtë vendit”, tha ai.


Deniz Yazici, nga zyra e OSBE-së në Vjenë, u shpreh se ka pasur një trend drejt censurës së internetit në Serbi. “Është përgjegjësi e qeverisë për të mbrojtur lirinë e shprehjes së mediave online dhe offline dhe të hetojë e dënojë aktet e censurës”, tha ai.

Diskutimi u zhvillua pasi kryeministri Aleksandër Vuçiç u ankua për rritjen e presionit mbi median për ta sulmuar atë, presion i cili, sipas tij, vinte nga ambasadorët në Beograd dhe nga jashtë. Ai u shpreh se pretendimet e OSBE-së se qeveria e tij kishte ushtruar presion mbi mediat në Serbi kanë qenë të rremë dhe janë pjesë e një fushate kundër tij. "Ata po gënjejnë, dhe kur dikush gënjen, minimumi i mirësjelljes është të kërkojë falje. Unë nuk do të lejoj askënd të sulmojë Serbinë", tha Vucic. Akuzat e Vucic erdhën pasi Paula Thiede, nënkryetarja e Misionit të OSBE-së në Serbi, i tha televizionit B92 se liria e medias në Serbi ishte duke u përballur me probleme serioze.

Së fundmi, faqja e internetit Pescanik.net u mbyll pas publikimit të pretendimeve se ministri i brendshëm Nebojsa Stefanović kishte bërë plagjiaturë në disa pjesë të tezës së tij të doktoraturës. Dy faqe interneti të tjera që kritikonin qeverinë janë mbyllur gjithashtu. Ndërkohë, Milorad Veljović, kreu i policisë, deklaroi se policia dhe Interpoli po hetojnë rastet e sipërpermendura.

Balkan Insight, qershor 2014

100 vjet më vonë: Kujtojmë Luftën e Parë Botërore



E shtëna që solli ndryshim në gjithë botën kumoi një mëngjes vere në Europën Juglindore. Asnjë nuk e mendonte që plumbi i vrasësit do sillte vdekjen jo vetëm të një aristokrati Austriak por të gjithë rendit global, me katër perandori dhe miliona jetë të humbura në një konflikt të një mase

të pa hasur më parë. Saktësisht 100 vjet më parë, në rrugët e Sarajevës, Franz Ferdinandi, trashëgimtar i fronit të Perandorisë Austro-Hungareze, dhe gruaja e tij, Sofia, u qëlluan nga një distancë jo të largët nga një nacionalist Serb Gavriolo Princip.

Vrasja i dha nismë një reaksioni zinxhir i cili arriti kulmin në një kontinent ku lufta kishte shpërthyer. Ajo çfarë shumë menduan se do mbetej një konflikt i shkurtër për më tepër dhe heroik, u transformua në një ankth katër-vjeçar i cili gllabëroi qindra kombe, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, rikrijoi hartën e Europës dhe prezantoi botën me horrortë reja si armët kimike dhe goditjet nga predhat. Një katastrofë e dytë globale, e cila i kishte rrënjët në të parën, pasoi brenda një gjenerate.

Më 28 qershor 2014, udhëheqës Europeanë u mbledhën për të përkujtuar sakrificat e luftës në një ceremoni solemne në Ypres, Belgjikë, ku ushtarë të panumërt gjetën vdekje në fushat me baltë të Flanders. "Kjo përkujtimore nuk po mbahet për fundin e luftës apo për ndonjë betejë ose fitore," tha Herman Van Rompuy, President i Këshillit të BE-së, dhe ish- kryeministër i Belgjikës. "Por mbi të gjitha, për ata miliona njerëz që u vranë nga të gjitha frontet." Van Rompuy përfaqëson Bashkimin e 28 kombeve, një pasqyrim i njerëzimit dhe solidaritetit rajonal të cilat 100 vjet më parë nuk mund të imagjinoheshin.

"Bashkimi është larg perfektes: Udhëheqësit patën mosmarrëveshje publikisht këtë javë për sa i përket kujt do i jepej një nga punët me të rëndësishme të Bashkimit European, dhe zgjedhjet e fundit të Parlamentit European nxorën fitues nga parti kundërshtarë të integritit të mëtejshëm. Por në 2012, Bashkimit European iu dha Çmimi Nobel i Paqes duke konsideruar sa larg ka lënë Europa të shkuarën e saj të ngjyer në gjak."

Si një shenjë tjetër e shërimit të plagëve, Presidenti Francez Francois Hollande do dedikojë një memorial të gdhendur me emrat e të gjithë 600,000 trupave të zhdukur në Francën veriore gjatë Luftës së parë, pavarësisht pranë cilës anë po luftonin.

Sipas historianes Annika Mombauer nga Britan's Open University "Duke konsideruar viktimat e panumërta që lufta shkaktoi, horrortë e paimagjinueshme që ajo solli kudo në botë, është e drejtë dhe e justifikueshme që të lindë pyetja se kush ishte përgjegjës për gjithë këtë katastrofë," ajo tha. "Sigurisht, ne nuk kemi arritur të biem dakord mbi një përgjigje të vetme në 100 vjet, dhe padyshim asnjëherë nuk do arrijmë."

Lufta e madhe theksoi ngritjen e Shteteve të Bashkuara dhe lindjen e një shekulli amerikan. Parimi i vetë-vendosjes së kombeve i cili akoma vazhdon të testohet, mori rrënjë. Tre muaj nga sot, Skocia do të votojë për pavarësinë nga Britania; Katalonja kërkon një referendum të ngjashëm për një shkëputje nga Spanja. Lufta i dha fund shumicës së dinastive. Revolucioni Rus çoi në krijimin e shtetit të parë komunist në botë; Gjermania e mundur pa lindjen e Republikës federale të Weimar. Perandoria Otomane u shpërbë në disa pjesë, ashtu si dhe harta e Lindjes së Mesme u rikrijua. Militantë islamikë këtë periudhë shkulën tabelat kufitare përgjatë kufirit midis Irakut dhe Sirisë, një vijë e krijuar pasi perandoria osmane ishte shpërbërë. Çështja kryesore për irakenët është nëse vendi i tyre, i përcaktuar nga ato kufij do të vazhdojë të ekzistojë. Ngjarja e hidhur politike që ende përndjek ish-Jugosllavinë dhe këndvështrimet e tyre mbi Gavriilo Princip mbeten të ndryshme. Sipas serbëve, ishte një hero nacionalist që goditi perandorinë Austri-Hungareze; për boshnjakët, aksionet e tij ndikuan në turbulencë që iu rikthyen shkatërrimit të qytetit të tyre gjatë Luftës Civile Ballkanike në vitet 1990. Nëpër Europë, jo vetëm rendi politik por dhe rendi i vjetër shoqëror u thërrmua si pasojë e Luftës së Parë Botërore.

“Lufta e Madhe... ishte një shkatërrim,” tha Van Rompuy. “Ky është fundi i botës së djeshme, fundi i perandorive, aristokracive dhe gjithashtu i një besimi të pafajshëm në përparim.”

Festimet u shoqëruan paraditen e 28 qershorit 2014 me një performancë nga Filarmonia e Vjenës-një simbolikë kjo nga kryeqyteti i një perandorie që dikur urrehej; dhe në mbrëmje pati një shfaqje muzikore në urën pranë të cilës ishin goditjet fatale.

BBC, qershor 2014

Kosovë: Pjesëmarrje e ulët në zgjedhjet parlamentare

Zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve thanë se procesi i zgjedhjeve ishte i rregullt dhe pa incidente. Sipas zyrtarëve të policisë së Kosovës nuk është shënuar asnjë incident serioz që mund ta dëmtonte procesin zgjedhor, ndonëse ka pasur disa raste të izoluara, kur u desh të ndërhynte policia. Në pjesën veriore të Kosovës kishte më shumë prani të forcave

ndërkombëtare të sigurisë të KFOR-it dhe EULEX-it dhe asnjëra nga këto mekanizma nuk njoftuan të jenë shënuar incidente. Pjesëmarrja në këto zgjedhje e pjesëtarëve të komunitetit serb në veri të Kosovës, shënon herën e parë të votimit në zgjedhjet e përgjithshme pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Po ajo që u vu re ishte një pjesëmarrje e ulët e popullsisë në votime. Vetëm 43,49% e 1.8 milionë qytetarëve të Kosovës me të drejtë vote e shfrytëzuan të drejtën e votës, njoftoi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve




pas mbylljes së qendrave të votimit. Në territoret e pakicës serbe në veri të vendit, pjesëmarrja ishte edhe më e ulët, njoftoi Lista Serbe. Pjesëmarrja në votime në Mitrovicë ishte 38.83%, në Leposavic 37.44%, në Zubin Potok 41.02% dhe në Zvecan vetëm 27.36%. Në deklaratat e para, abstenimi i zgjedhjeve u shpjegua me gjendjen e mjeruar ekonomike dhe sociale si dhe me korrupsionin që sundon gjithçka në Kosovë. Sipas Koalicionit të Organizatave Joqeveritare “Demokracia në Veprim” procesi zgjedhor në veri të vendit është zhvilluar normalisht dhe nuk ka pasur parregullsi. Por dalja e votuesve në zgjedhje sipas tyre ka qenë e ulët.

Zgjedhjet parlamentare u vëzhguan nga mbi 30 mijë vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë. 100 vëzhgues ishin nga Bashkimi Europian. Dy partitë më të mëdha politike në vend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) zgjedhjet parlamentare të 8 qershorit i vlerësuan të suksesshme dhe demokratike.

Deutsche Welle, qershor 2014

A E DINI SE?



Programi ERASMUS thyen rekordet

- Programi i shkëmbimit të studentëve Erasmus ka financuar 270 mijë studentë gjatë vitit akademik 2012/2013
- Komisionerja e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë Androulla Vassiliou u shpreh se ky rekord flet qartë për popullaritetin që ka ky program
- Sipas statistikave, fondi mesatar Erasmus që mbulon një pjesë të jetesës dhe udhëtimit është 272 € në muaj, duke u rritur me 9% nga vjet
- Që nga themelimi i tij më 1987, Erasmus është bërë pjesë e pandashme e politikave të BE-së dhe ka financuar 3 milion studentë. Ky program tanimë ka zgjeruar fushat e financimit duke përfshirë financimet për vende pune dhe trajnimet pedagogjike.
- Destinacionet më të populluara nga studentët Erasmus ishin Spanja, Franca dhe Gjermania
- Shtetet që kanë dërguar numrin më të madh të studentëve në proporcion me popullsinë e diplomuar ishin Luksemburgu, Lihtenshtejni, Finlanda, Letonia dhe Spanja.
- Malta përjetoi rritjen më të lartë të studentëve që përdorin programin, ndjekur nga Qipro dhe Kroacia.
- Rreth 15 bilion € janë ndarë për programin "Erasmus+", i cili sjell së bashku programet europiane për edukim dhe trajnim deri në 2020, dhe për të cilin Komisioni European thotë se do të financojë 2 milion studentë.

Cilat janë Trendet e Turizmi në Europë 2014?

- Ka një rritje të turizmit të fokusuar në vizitat e qyteteve historike europiane, krahasuar me turizmin në zona bregdetare.
- Turizmi po përqendrohet së fundmi në Europën Qendrore dhe atë Jugore krahasuar me Europën Veriore. Vende si Malta, Portugalia dhe Kroacia po përjetojnë një rritje të numrit të pushuesve me 6-8%.

- Në pjesën veriore të Rumanisë ekziston një varrezë, në mbrojtje të UNESCO-s, e cila është një pikë turistike e famshme për shkak të stilit të veçantë të



varreve. Këto të fundit janë të ngjyrosur me ngjyra të ndezura dhe me piktura që tregojnë historinë e vdekjes së personit.

- Kryesisht në Europën Juglindore, në vende si Estonia vihet re zhvillimi i eko-turizmit. Eko-turizmi promovon zonat natyrore të brishta dhe të pacenuara nga komercializmi. Ky lloj turizmi synon edukimin e turistëve dhe udhëtarëve në sigurimin e fondeve për ruajtjen ekologjike, dhe nxitjen e respektit për kulturat e ndryshme dhe të drejtat e njeriut.

- Ndërkohë që në vitin 2013 prenotimet online të pushimeve përbënin 65% të prenotimeve të përgjithshme, në vitin 2014 kjo shifër pritet të rritet së tepërmi.



- Udhëtimet peer-to-peer janë trendi i vitit 2014. Të rinj nga vende të ndryshme të botës presin njëri-tjetrin në shtëpi, në mënyrë që të ulin kostot e udhëtimeve. Faqet

online me te klikuara për udhëtimet peer to peer janë: www.airbnb.com, <https://www.couchsurfing.org/>; <http://www.iloho.com/>;

- Në Kroaci 70% e akomodimeve janë private dhe vetëm 30% janë hotele.

Mendoni se dini gjithçka mbi BE-në?
Provojeni veten me këtë Quiz!

- 1 Cili nga shtetet e mëposhtme themeluese mund të konsiderohet të kenë pasur momente të rëndësishme në histori në të cilat është orientuar më shumë drejt ndërkombëtarizimit në krahasim me 3 të tjerët?
 - o Belgjika
 - o Holanda
 - o Franca
 - o Luksemburgu
- 2 Në cilin vit u nënshkrua Traktati i Nicës?
 - o 1986
 - o 1997
 - o 1992
 - o 2001
- 3 Cilat shtete, përveç Mbretërisë së Bashkuar, nuk ishin bashkuar me Euro-n deri në janar 2001?
 - o Austria
 - o Greqia
 - o Danimarka dhe Suedia
 - o Portugalia dhe Spanja

- 4 Pse ka 12 yje në flamurin europian?
 - o Ourapanos, europiani i pare mitik ka 12 djem
 - o Unioni administrohet nga 12 komisionerë
 - o Për të përfaqësuar 12 shtete anëtare
 - o Është një numër që përfaqëson perfeksion dhe tërësi
- 5 Cili është zakonisht vendi i diskutimit të dispozitave për traktatet e reja?
 - o Këshilli i Europës
 - o Këshilli i Ministrave
 - o Konferenca Ndërqeveritare (IGCs)
 - o Parlamenti European
- 6 Sa shtete iu bashkuan Europës në 2004?
 - o 5
 - o 8
 - o 10
 - o 12

Përgjigjet

- 1 - Franca
- 2 - 2001
- 3 - Danimarka dhe Suedia
- 4 - Është një numër që përfaqëson perfeksion dhe tërësi
- 5 - Konferenca Ndërqeveritare (IGCs)
- 6 - 10



EuroSpeak Online!

EuroSpeak vjen tek lexuesi me një portal online dedikuar lajmeve dhe analizave mbi integrimin europian. Më i përditësuar, më interesant, më afër lexuesit. EuroSpeak, Dritarja Juaj në Europën e Bashkuar!
www.eurospeak.al

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballen Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Programit Europe for Citizens të Komisionit European.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org

twitter.com/EMAlbania
facebook.com/EMinALB

European Movement-Albania
 Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.9, Tiranë, Albania,
 Nr. Tel/Fax: +355 4 2253184, www.em-al.org, info@em-al.org

